

Attached is an advance copy of the **Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo** for the information of the members of the Security Council.

This report will be issued as a document of the Security Council under the symbol S/2020/964.

1 October 2020

# **Raport i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë**

## **I. Hyrje dhe prioritetet e Misionit**

1. Ky raport parashtrohet në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, përmes së cilës Këshilli themeloi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe kërkoi nga unë që të raportoj në intervale të rregullta për zbatimin e mandatit të tij. Në raport mbulohen aktivitetet e UNMIK-ut dhe zhvillimet lidhur me to nga data 16 mars deri më 15 shtator 2020.

2. Prioritetet e Misionit mbesin avancimi i sigurisë, stabilitetit dhe respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe në regjion. Në çuarjen përpara të qëllimeve të tij, UNMIK-u vazhdon angazhimin konstruktiv me Prishtinën dhe Beogradin, me të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe me palët regjionale e ndërkombëtare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Forca e Kosovës (KFOR) vazhdojnë të kryejnë rolet e tyre brenda kornizës së Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit. Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) vazhdon praninë e tij në Kosovë në përputhje me deklaratën e kryetarit të Këshillit të Sigurimit të datës 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44) dhe me raportin tim të datës 24 nëntor 2008 (S/2008/692). Agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara punojnë ngushtë me Misionin.

## **II. Zhvillimet kryesore politike dhe të sigurisë**

3. Populli dhe institucionet e Kosovës janë ballafaquar me sfida të ndryshme dhe të ndërthurura. Më e madhja prej tyre ishte kriza e pandemisë COVID-19, e cila përveç se preku shëndetin publik, gjithashtu pati edhe pasoja të rënda ekonomike, shoqërore e politike. Përhapja e virusit u përshpejtua gjatë pjesës së dytë të periudhës raportuese, duke shkaktuar humbje të jetës dhe dëmtim të ekonomive familjare në mbarë Kosovën, si dhe duke shkaktuar presion të madh në kapacitetin e institucioneve publike për të reaguar ndaj pandemisë. Kriza e pandemisë është shoqëruar me krizë politike, pasi që qeveria e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, Vetëvendosje (VV), është rrëzuar përmes mocionit të mosbesimit të iniciuar nga partneri i koalicionit, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), vetëm dy muaj pas fillimit të mandatit. Shpallja nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në qershor se është ngritur aktakuza në Hagë për krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit kundër presidentit Hashim Thaçi dhe udhëheqësit të ish-partisë së tij, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, solli edhe më shumë ndërlikime në skenën politike në Prishtinë.

Këto zhvillime dhe sfida i kanë bërë më të brishta rrethanat politike dhe të sigurisë në Kosovë, në kohën kur bota po mundohet të luftojë dhe menaxhojë pandeminë COVID-19.

4. Më 18 mars në Kosovë u raportuan disa nga rastet e para të konfirmuara me COVID-19. LDK-ja u tërhoq nga koalicioni me VV-në, e cila kishte fituar shumicën e votave në zgjedhjet e tetorit 2019, dhe inicioi mocionin e suksesshëm të mosbesimit ndaj qeverisë së udhëhequr nga VV e Albin Kurtit. Tensionet ndërpartiake po ngriheshin dhe dallimet u bënë publike, duke përfshirë thirrjet për heqjen e pakushtëzuar të taksës 100 për qind për mallrat e importuara nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, e cila ishte vendosur në vitin 2018 nga ish-qeveria e udhëhequr nga kryeministri i atëhershëm Haradinaj. Pas shkarkimit nga ana e Kurtit të ministrit

të Punëve të Brendshme dhe zëvendëskryeministrit të parë nga radhët e LDK-së, të cilin e kishte akuzuar për kundërshtim të hapur të reagimit të qeverisë ndaj pandemisë COVID-19, LDK-ja doli nga koalicioni, duke e quajtur këtë akt si shkelje të papranueshme të marrëveshjes së saj për koalicion me VV-në.

5. Më 25 mars, 82 nga 120 deputetët e Kuvendit të Kosovës votuan në favor të mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë Kurti. Si reagim ndaj kësaj, Kurti dhe partia e tij ftuan për caktim të menjëhershëm të zgjedhjeve të reja. Pas konsultimeve me shumicën e partive politike, presidenti Thaçi erdhi në përfundim se shumica e partive ishin për krijimin e një qeverie të re. Më 30 prill, pasi që VV-ja nuk ktheu përgjigje për caktimin e një kandidati tjetër për kryeministër, presidenti Thaçi ftoi LDK-në, si parti që u rendit e dyta për nga numri më i madh i votave në zgjedhjet e fundit, që të formojë qeverinë e re. VV-ja kundërshtoi këtë veprim, duke e dërguar në Gjykatën Kushtetuese, e cila më 28 maj e mbështeti vendimin e presidentit. Njëkohësisht me protestat e vazhdueshme të VV-së dhe me pakënaqësinë e hapur të qytetarëve për tensionet politike gjatë emergjencës së shëndetit publik, më 3 qershor Kuvendi i Kosovës me shumicë të vogël votash shpalli qeverinë e re që do të udhëhiqej nga zëvendëskryetari i LDK-së, Avdullah Hoti.

6. Qeveria e re varet nga një votë e shumicës që e ka në Kuvend, dhe përbëhet nga disa parti më të vogla shqiptare, duke përfshirë Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismën për Kosovën (NISMA/NpK), së bashku me partinë e serbëve të Kosovës, Lista Serbe, si dhe me partitë që përfaqësojnë komunitetet joshumicë. Kabineti i kryeministrit Hoti është paksa më i madh se sa ai i qeverisë së mëparshme, me katër zëvendëskryeministra dhe 16 ministra (më parë kanë qenë 15), duke përfshirë edhe tri femra ministre, krahasuar me pesë sa ishin në qeverinë paraprake.

7. Pas marrjes së mandatit, qeveria e re prioritetizojë ballafaqimin me pandeminë dhe lehtësimin e rimëkëmbjes ekonomike, luftimin e krimit dhe korrupsionit, avancimin e dialogut me Beogradin dhe përparimin në integrimet evropiane. Po ashtu, qeveria i hoqi kufizimet jotarifore, duke përfshirë masat e reciprocitetit në mallrat serbe, të cilat i kishte vendosur qeveria e mëparshme e LVV-së, por theksoi se nëse nuk arrihet përparim i nevojshëm në dialogun me Beogradin të njëjtat prapë do të mund të riktheheshin. Megjithatë, kundërshtimet e vazhdueshme politike vonuan miratimin e legjislationit për menaxhimin e pandemisë dhe zbutjen e ndikimit të saj në ekonomi. Ligji i ri për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 më në fund është miratuar më 14 gusht, diku rreth tre muaj pasi që Gjykata Kushtetuese kishte rekomanduar ndryshimet urgjente legjislative për mbështetjen e masave të futura nga qeveria për mospërhapjen e virusit. Në korrik, pas disa përpjekjeve të pasuksesshme si rrjedhojë e mungesës së kuoromit, Kuvendi gjithashtu ratifikoi pesë marrëveshje ndërkombëtare financiare me Bankën Botërore, Bashkimin Evropian dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, përmes të cilave në mes të tjerash përkrahet modernizimi i administratës tatimore dhe doganore të Kosovës dhe ligji për buxhetin shtesë. Gjatë muajit gusht, Kuvendi ratifikoi edhe dy marrëveshje të tjera financiare të një rëndësie të madhe për rimëkëmbjen ekonomike, gjegjësisht një marrëveshje me Bankën Botërore dhe një marrëveshje tjetër të huas për asistencë makrofinanciare me Bashkimin Evropian. Si reagim ndaj pandemisë COVID-19, qeveria propozoi një plan të rimëkëmbjes ekonomike në vlerë prej 1,2 miliard euro, i cili ende pret miratimin në Kuvend.

8. Më 24 qershor, Zyra e Prokurorit të Specializuar shpalli se më datën 24 prill 2020 Dhomat e Specializuara të Kosovës kishin dorëzuar aktakuzën, të përbërë nga 10 pika të akuzës, kundër presidentit Thaçi, kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli dhe kundër disa individëve të tjerë. Në këtë aktakuzë ata akuzohen për krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit, duke përfshirë vrasje, zhdukje të dhunshme të personave, përndjekje dhe torturë. Aktakuza pret shqyrtimin dhe konfirmimin nga gjyqtari i procedurës paraprake i Dhomave të Specializuara, e cila sipas Rregullores në fuqi të punës dhe dëshmime pritët të ndodh para fundit të muajit tetor. Zyra e Prokurorit të Specializuar, deklaroi se akuzat po publikoheshin paraprakisht për shkak të “përpjekjeve të përsëritura të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit për të penguar dhe minuar punën e DhSK (Dhomave të Specializuara të Kosovës).” Duke reaguar në këtë shpallje, kryeministri Hoti kërkoi që Gjykata Speciale të respektohet. z. Veseli në një deklaratë tha se “motivet e vërteta” të prokurorit ishin “tërësisht politike”. Presidenti Thaçi i përshkroi pretendimet si “false”, duke premtuar se do të jepte dorëheqje në rast të konfirmimit të aktakuzës nga ana e Dhomave të Specializuara.

9. Në një adresim televiziv më 18 korrik, presidenti Thaçi e karakterizoi procesin “si edhe një tjetër në mesin e akuzave, pretendimeve dhe fabrikimeve 21-vjeçare për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe për përpjekjet e popullit të Kosovës për liri e sovranitet”. Kuvendi i Kosovës në ndërkohë miratoi një rezolutë joobliguese lidhur me unitetin politik e qytetar në mbrojtjen e vlerave të popullit të Kosovës, duke thirrur në mes të tjerash “që të mbrohet lufta çlirimtare e UÇK-së” (Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës), që të trajtohet çështja e personave të zhdukur, që të sigurohet drejtësi “për të gjitha viktimat e krimeve të Serbisë”, si dhe që të ketë paañesi të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Rreth 20 milionë euro janë miratuar nga buxheti i Kosovës për përkrahjen e të akuzuarve të mundshëm dhe familjeve të tyre. Përveç kësaj, ka rifilluar debati lidhur me Propozimligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili nuk u miratua në leximin e parë më 13 gusht për shkak të mungesës së kuorumit. Palët ndërkombëtare dhe organizatat vendore për të drejtat e njeriut kanë kritikuar fuqishëm elementet e këtij propozimteksti, duke theksuar se mund të shkel lirinë e shprehjes dhe të drejtat e tjera themelore, të garantuara me Kushtetutë dhe me norma të tjera ndërkombëtare. Më 14 gusht, Shoqata e Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i dërgoi peticion Kuvendit për ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar në mënyrë që të zgjerohet juridiksioni i tyre për krimet e kryera nga forcat serbe. Më 24 gusht, presidenti Thaçi i parashtroi kërkesë Kuvendit të Kosovës për të ndryshuar Kushtetutën me qëllim të sqarimit të përfundimit të mandatit të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

10. Këto zhvillime ndodhen në sfondin e debatit të vazhdueshëm publik dhe spekulimeve për qëndrueshmërinë e qeverisë së koalicionit të udhëhequr nga LDK. Më 6 gusht, VV-ja deklaroi se ishte në proces të grumbullimit të nënshkrimeve në Kuvendin e Kosovës për inicimin e mocionit të mosbesimit kundër qeverisë Hoti. Përveç kësaj, palët politike kanë filluar diskutimet publike për zgjedhjen e presidentit të ri në rast se presidenti Thaçi jep dorëheqje para fundit të mandatit të tij në prill të vitit 2021.

11. Rifillimi i punëve nga komuna e Deçanit në rrugën e transitit për Mal të Zi përmes Zonës së posaçme të mbrojtur të manastirit të Deçanit, në kundërshtim me ligjet në fuqi, rindezi tensionet politike dhe të sigurisë gjatë periudhës raportuese. Pas rifillimit të punëve rugore në

Zonën e posaçme të mbrojtur në mesin e korrikut, dioqeza e Rashkës dhe Prizrenit i apeloj qeverisë së Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare që të parandalojnë punimet e mëtejme në Zonën e posaçme të mbrojtur. Beogradi gjithashtu publikisht denoncoi punimet e reja, ku presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq kërkoi që çështja e Zonave të posaçme të mbrojtura të përfshihet në agjendën e sesionit të ardhshëm të bisedimeve të ndërmjetësuar nga BE mes Beogradit dhe Prishtinës. Më 16 gusht, pas vizitës të kryeministrit Hoti në këtë komunë, punimet u ndalën. Më 27 gusht, pas një vizite faktmbledhëse në zonë, përfaqësuesit e Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të vendosur në Prishtinë, të cilët u shoqëruan nga zyrtarët e BE-së, OSBE-së dhe KFOR-it, ftuan qeverinë e Kosovës që të respektoj Ligjin për Zonat e posaçme të mbrojtura dhe të siguroj zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, të datës 19 maj 2016, përmes të cilit mbështeten të drejtat pronësore të Kishës në tokë. Komuna nga ana tjetër deri më tani nuk është zotuar për ndalim të përhershëm të punimeve të paligjshme rrugore.

12. Nga mesi i marsit deri në fund të majit, kur ishin në fuqi masat kufizuese të pandemisë, në bashkësitë e serbëve në Vushtrri, Novakë, Prizren, Istog, Gjilan dhe Obiliq u regjistruan rritje të incidenteve kriminale, të drejtuara kundër pronës dhe pasurisë së tyre. Më 1 maj, Përfaqësuesi im Special së bashku me përfaqësuesit e tjerë ndërkombëtarë të nivelit të lartë në Kosovë, shfaqën shqetësimin për rritjen e incidenteve të këtilla, dhe ftuan autoritetet e Prishtinës që të kenë prioritet zbatimin e ligjit për këto komunitete, që të identifikojnë shpejtë kryerësit dhe që të dekurajojnë publikisht veprat e tilla.

### **III. Ndikimi i COVID-19 dhe reagimi ndaj tij**

13. Përkundër reagimit të hershëm dhe masave të rrepta kundër pandemisë, të cilat fillimisht rezultuan me mbajtje relative të virusit nën kontroll, në fillim të qershorit gjendja filloi të përkeqësohet që përkoi me lehtësimin e kufizimeve me qëllim të rifillimit të aktivitetit të rregullt ekonomik. Të ballafaquar me rritjen dramatike të numrit të rasteve, gjatë korrikut qeveria rikthej disa nga kufizimet. Ndër to ishin ndalimi i qarkullimit gjatë natës; ndalimi i grumbullimeve të qytetarëve dhe mbajtja e obligueshme e maskës në hapësirat e mbyllura publike. Respektimi i masave ka qenë jokonsekuent, ku ndikimi i tyre në ngadalësimin e shkallës së infektimit ka qenë e kufizuar. Deri në fund të periudhës raportuese, janë raportuar së paku 15,000 raste të COVID-19 dhe mbi 600 vdekje. Në mesin e masave të tjera, me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare janë duke u bërë përpjekje për rritjen e kapaciteteve testuese në Kosovë. Sistemi i shëndetësisë publike i Kosovës në shumë raste është tejngarkuar përtej kapaciteteve të tij ekzistuese, duke përfshirë shtretërit në dispozicion për pacientët me COVID-19, testimet, pajisjet esenciale mjekësore dhe numrin e kujdestarëve të kualifikuar e të stafit tjetër mjekësor. Deri më 9 shtator, rreth 11 për qind të të gjitha rasteve të regjistruara janë punëtorë shëndetësorë.

14. Reagimi ndaj pandemisë në Kosovë gjithashtu ka qenë i ndikuar nga veprimtaritë ekzistuese të strukturave publike shëndetësore të mbështetura nga qeveria e Serbisë në vendet e banuara me shumicë serbe në Kosovë. Edhe pse në shumë raste bashkëpunimi i atypëratyshëm mes sistemeve të udhëhequra nga Beogradi e Prishtina ka funksionuar mirë, ky bashkëpunim nuk ka qenë sistematik. Përmes këtyre dy sistemeve në masë të madhe janë arritur të zbatohen rregullimet praktike për lëvizjen e lirë të mostrave të testeve, të pajisjeve

esenciale mjekësore, të personelit dhe të pacientëve. Në fazat e hershme të pandemisë, dallimet mes kufizimeve të caktuara nga institucionet e Prishtinës dhe Beogradit kanë qenë të zakonshme, por me kalimin e kohës ato u sinkronizuan më shumë. UNMIK-u dhe agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara kanë qëndruar funksionale gjatë pandemisë, duke zbatuar njëkohësisht masat për zvogëlimin e rrezikut, duke përfshirë edhe punën nga shtëpia. UNMIK-u dhe Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT) vazhdojnë që për së afërmi t'i bashkërendojnë përpjekjet për të siguruar mirëqenien e punonjësve dhe vazhdimësinë e punës, si dhe të përkrahin pushtetin dhe institucionet vendore. Përfaqësuesi im Special që në fillim kishte caktuar si prioritet përmirësimin e kapaciteteve mjekësore në vendpunim në mënyrë që të shërbehen të gjithë punonjësit e Kombeve të Bashkuara në teren. Rrjedhimisht, UNMIK-u është pajisur me pajisje të sigurta, hapësira dhe me personel të specializuar për trajtimin e punonjësve të OKB-së dhe të familjarëve të tyre të ngushtë, përveç në rastet më kritike ku kërkohet evakuimi mjekësor. Përfaqësuesi im Special kanë qenë personalisht i përfshirë me autoritetet në Beograd e Shkup, Maqedoni e Veriut, lidhur me arritjen e marrëveshjeve për evakuim mjekësor të punonjësve të OKB-së dhe të familjarëve të tyre të ngushtë. UNMIK-u dhe UNKT-ja gjithashtu kanë bashkëpunuar me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë në testimin e punonjësve me simptoma. Megjithatë, kapacitetet testuese të Institutit kanë qenë të ngarkuara për shkak të kërkesës së madhe, kështu që UNMIK-u ka nënshkruar marrëveshje edhe me laboratorët e tjerë vendor për realizimin e testeve RT-PCR (*Reverse Transcription of Polimerase Chain Reaction* - Transkripcioni i Anasjelltë i Reagimit Zingjiror të Polimerazës). Deri në fundin e periudhës raportuese, në mesin e punonjësve të Kombeve të Bashkuara dhe të familjarëve të tyre të ngushtë në Kosovë janë regjistruar 23 raste të konfirmuara të infektimit me COVID-19. Këtu përfshihen 17 raste në mesin e punonjësve të UNMIK-ut dhe të familjarëve të tyre të ngushtë (14 të shëruar dhe 3 raste aktive) dhe gjashtë nga radhët e punonjësve të UNKT-së dhe familjarëve të tyre të ngushtë (ku të gjithë janë shëruar).

15. UNMIK-u, në bashkëpunim të ngushtë me UNKT-në, ka kanalizuar resurset në dispozicion drejt përkrahjes së institucioneve publike shëndetësore dhe të popullatës së Kosovës, ku veçanërisht kjo përkrahje është drejtuar në plotësimin e nevojave urgjente të grupeve më të cenueshme të popullatës. Misioni përshtati një pjesë të madhe të aktiviteteve të tij programore drejt reagimit ndaj emergjencës së COVID-19. Së këndejmi, shpërndau pako ushqimore dhe të higjienës, Pajisje Personale Mbrojtëse (PPM) dhe pajisje për mësim nga distanca në të gjitha komunat e Kosovës. Duke iu përgjigjur kërkesave të autoriteteve shëndetësore, në mes të tjerash, UNMIK-u gjithashtu ofroi pajisje mjekësore dhe PPM Ministrisë së Shëndetësisë, policisë dhe zjarrfikësve, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës. UNMIK-u po ashtu inicoi një numër projektesh për rini dhe çështje gjinore, të përshtatura për t'i kontribuar reagimit ndaj COVID-19, duke përfshirë përkrahjen për strehimoret e viktimave të dhunës në familje në mbarë Kosovën, si dhe prodhimin e shpërndarjen e mbrojtëseve të fytyrës për punëtorët shëndetësorë.

16. UNKT-ja i ka dhënë mbështetje kyçe qeverisë në reagimin ndaj COVID-19, nën drejtimin e përgjithshëm të Koordinatorit Rezident të UNKT-të, përmes bashkërendimit të ndihmesës emergjente për t'u ballafaquar dhe shpërthimin e pandemisë. Organizata Botërore e Shëndetësisë, në bashkërendim të ngushtë me agjencitë e tjera të UNKT-së, ka luajtur rol kryesor në këshillimin dhe përkrahjen e institucioneve të shëndetit publik në Kosovë për

luftimin e pandemisë. Me rritjen e shkallës së infektiveve gjatë verës, OBSH ka dërguar misione teknike dhe ekspertë shtesë në Kosovë, si dhe ka lehtësuar prokurimin e pajisjeve esenciale, siç janë koncentruerit e oksigjenit dhe ventilatorët ICU. Ekspertët janë angazhuar në dhënien e ndihmesës për ngritjen e kapaciteteve të gjurmimit, komunikimit të rrezikut dhe parandalimin e infeksionit, si dhe në menaxhimin e rasteve dhe testim. Që nga marsi, anëtarët e UNKT-së kanë realizuar ndihmesë dypalëshe dhe shumëpalëshe në vlerë prej 27 milionë dollarë amerikanë. Në qershor, UNKT-ja përfundoi vlerësimin e ndikimit socio-ekonomik dhe planin e reagimit të agjencive të fokusuar në shëndetësi, mbrojtje sociale, rimëkëmbje ekonomike, reagimin makroekonomik, kohezionin social dhe qëndrueshmërinë e komunitetit. Të gjitha këto janë bërë me qëllim të fuqizimit të reagimit të qeverisë ndaj pandemisë COVID-19.

#### **IV. Veriu i Kosovës**

17. Më 16 qershor, kryetari i komunës së Mitrovicës së Veriut dhe kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiq, dha dorëheqje në mënyrë që të merr postin e zëvendëskryeministrit të Kosovës dhe ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal. Pas një takimi konsultativ me përfaqësuesit e partive politike dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më 22 qershor, presidenti Thaçi deklaroi se për shkak të rrethanave të pandemisë, zgjedhjet e jashtëzakonshme komunale nuk do të caktoheshin deri në tetor 2020. Më 21 qershor, u zhvillua votimi në Kosovë për zgjedhjet parlamentare në Serbi. Siç ndodhi edhe në të kaluarën, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ndihmoi në grumbullimin e votave, gjithnjë duke pasur kujdes për ruajtjen e shëndetit. Këto zgjedhje kaluan pa incidente apo parregullsi të mëdha në 20 vende dhe në 140 vendvotime në Kosovë.

18. Më 2 prill, kryetarët e komunave Mitrovicë e Veriut dhe Mitrovicë e Jugut, të shoqëruar nga komandanti i KFOR-it (Forca e Kosovës), Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), gjatë një konference të përbashkët për media, të mbajtur në urën kryesore mbi lumin Ibër, u apeluan banorëve të të dy komunave që t'iu përmbahen masave të shëndetit publik të lidhura me COVID-19. Kjo ishte hera e parë që nga tetori i vitit 2018 kur kryetarët e këtyre dy komunave kishin lëshuar një deklaratë publike së bashku.

19. Më 29 korrik, ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës vizituan komunën e banuar me shumicë serbe të Zubin Potokut për të diskutuar sfidat e sigurisë, me të cilat ballafaqohet komuna gjatë pandemisë, duke përfshirë sigurimin e përpjekjeve më të bashkërenduara për sigurimin e rendit dhe ligjit në luftimin e krimit të organizuar përgjatë vijave komunale dhe të komuniteteve.

#### **V. Normalizimi i marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës**

20. Përpjekjet vazhduan për rifillimin e dialogut të ndihmuar nga BE-ja mes Beogradit dhe Prishtinës, i cili ishte pezulluar që nga nëntori i vitit 2018. Më 3 prill, Bashkimi Evropian emëroi Miroslav Lajčák si Përfaqësues Special për dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës dhe për çështjet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Ky emërim u mirëprit gjatë samitit të BE-së për Ballkanin Perëndimor më 6 maj nga BE-ja dhe nga udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor, të cilët gjithashtu rikonfirmuan perspektivën evropiane të regjionit dhe

përkushtimin për të intensifikuar angazhimin e tyre në përkrahje të transformimit politik, ekonomik e social të regjionit. z. Lajčák bëri vizita përgatitore në Prishtinë dhe Beograd gjatë qershorit me qëllim të diskutimit të modaliteteve të takimeve të ardhshme brenda kontekstit të dialogut.

21. Më 10 korrik, Franca dhe Gjermania ishin nikoqir të takimit virtual me presidentin e Serbisë, Vuçiq, dhe kryeministrin e Kosovës, Hoti, i cili u pasua nga takimi virtual i drejtuar nga BE-ja me dy liderët më datën 12 korrik për të shënuar rifillimin zyrtar të dialogut të ndihmuar nga BE-ja. Takimet sy me sy të liderëve pasuan më 16 korrik dhe më 7 shtator nën organizimin e përfaqësuesit të lartë të BE-së për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë /zëvendëspresidentin e Komisionit Evropian, Josep Borrell, dhe të përfaqësuesit special të BE-së Lajčák, si dhe në nivel ekspertësh. Këto takime u fokusuan në çështjet e ndërlidhura me personat e zhdukur dhe personat e zhvendosur, si dhe në bashkëpunimin ekonomik. Para takimit të 7 shtatorit, presidenti Vuçiq dhe kryeministri Hoti, lëshuan një deklaratë të përbashkët, duke theksuar se i kushtonin “prioritetin më të lartë” integritet në BE dhe vazhdimin të dialogut të ndihmuar nga BE-ja. Ata gjithashtu u përkushtuan për dyfishimin e përpjekjeve për të siguruar përafrim të mëtejme me BE-në në përputhje me obligimet e tyre përkatëse. Njëkohësisht, palët vazhduan të paraqisnin deklarata të ndryshme lidhur me rezultatet e pritura nga dialogu, ku Prishtina këmbëngul në njohjen e ndërsjellë, ndërsa Beogradi thekson rëndësinë e zbatimit të marrëveshjeve ekzistuese.

22. Më 4 shtator, nën organizimin e Shteteve të Bashkuara, presidenti Vuçiq dhe kryeministri Hoti u takuan në Uashington, ku nënshkruan zotime të ndara dhe u pajtuan që të ecin përpara me normalizimin ekonomik. Sipas dokumenteve, Beogradi dhe Prishtina në mes të tjerash u zotuan që të zbatojnë rihapjen e dakorduar të lidhjes hekurudhore dhe ndërtimin e autoudhës, si dhe që të punojnë me qeverinë e ShBA-ve lidhur me studimin e fizibilitetit për qëllim të shfrytëzimit të përbashkët të liqenit të Gazivodës/Ujmanit si furnizues të qëndrueshëm të ujit dhe energjisë. Të dyja palët gjithashtu u pajtuan që Kosova t'i bashkohet zonës së ashtuquajtur të Mini Shengenit, ku Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut tanimë janë anëtare. Në dokument po ashtu përfshihen marrëveshjet nga Prishtina e Beogradi që të pezullohen për një periudhë njëvjeçare fushatat e tyre përkatëse të njohjes dhe çnjohjes.

23. Në prill, anëtarët e Grupit Regjional të Evropës Kontinentale të Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike (ENTSO-E) miratuan një marrëveshje të lidhjes me Sistemin e Transmisionit të Energjisë Elektrike të Kosovës dhe Operatorin e Tregut (KOSST), përmes së cilës këtij të fundit i mundësohet bashkimi me rrjetin regjional të operatorëve në Evropë. Marrëveshja u nënshkrua më 30 qershor, ku autorizohet KOSTT-i që të dalë nga zona rregullative e Serbisë brenda bllokut më të madh regjional të kontrollit, ku gjithashtu mbulohet Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, dhe të operojë si zonë e pavarur rregullative me Republikën e Shqipërisë. Ky vendim është në përputhje me marrëveshjen për energji të vitit 2013 mes Beogradit dhe Prishtinës, të ndihmuar nga BE-ja, ku në mes të tjerash parashihet që KOSTT-i të bëhet operator zyrtar i sistemit të transmisionit në Kosovë.

## **VI. Kthimet, pajtimi, trashëgimia kulturore dhe marrëdhëniet mes komuniteteve**



24. Gjatë periudhës raportuese, Zyra e Komisionerit të Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara (UNHCR) regjistroi 189 kthime vullnetare të individëve nga komunitetet joshumicë, të cilët kanë qenë të zhvendosur brenda Kosovës dhe jashtë saj. Nga ky numër i të kthyerve 102 janë femra dhe 87 meshkuj (116 serbë, 22 romë, 36 egjiptas, 12 shqiptarë dhe tre boshnjakë). Këto kthime e sjellin numrin gjithsej të anëtarëve të zhvendosur të komuniteteve joshumicë, të cilët kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme në Kosovë që nga viti 2000, në 28.547, ku përfshihen 14.021 femra dhe 14.526 meshkuj (12,207 serbë, 7,670 egjiptas dhe ashkali, 3,990 romë, 1.878 boshnjakë, 1.464 goranë, 1,294 shqiptarë, 21 malazez, 19 turq dhe katër kroatë). Ende mbesin 16.052 persona të zhvendosur brenda Kosovës (7.404 femra dhe 8.648 meshkuj), si dhe 69.627 persona me nevoja të lidhura me zhvendosjen në regjionin e Ballkanit Perëndimor. Shumica e përafërsisht 200.000 personave të zhvendosur nga Kosova që banojnë në regjion gjenden në Serbi.

25. Më 29 maj, një grup teknik i përbërë nga përfaqësuesit e lartë nga Beogradi, Podgorica, Prishtina dhe Shkupi mbajtën një takim virtual në kuadër të Procesit të Shkupit, nismë kjo regjionale e organizuar bashkërisht mes Zyrës së Komisionarit të Lartë për Refugjatë (UNHCR) dhe OSBE-së për të avancuar zgjidhjet e qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova. Pjesëmarrësit vlerësuan zbatimin e pikave paraprakisht të dakorduara dhe u zotuan të hartojnë planet e veprimit në kuadër të pesë fushave kryesore: (i) të drejtat pronësore; (ii) siguria; dialogu dhe reintegrimi; (iii) dokumentet personale; (iv) menaxhimi i të dhënave dhe (v) planifikimi i zgjidhjeve.

26. Më 28 mars, Zyra e Komisionerit për Gjuhë e Kosovës botoi raportin e saj vjetor lidhur me respektimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga komunat e Kosovës. Në raport konstatohet se komunitet joshumicë në Kosovë vazhduan të ballafaqohen me pengesa lidhur me qasjen në drejtësi, regjistrim të pronës dhe me kujdes shëndetësor si rrjedhojë e mosfrimit të duhur të materialeve dhe shërbimeve në të gjitha gjuhët zyrtare. Më 15 prill dhe 9 qershor, përfaqësuesit serbë të shoqërisë civile parashtruan ankesa zyrtare në Zyrën e Komisionerit për Gjuhë përkitazi me mosrespektimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga institucionet e Kosovës lidhur me shpërndarjen e informatave për COVID-19.

27. Më 3 gusht, Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) filloi projektin për vlerësimin e nevojave dhe monitorim me partnerët e saj vendorë në komunën e Gjakovës, i cili ka për qëllim përmirësimin e qasjes së komuniteteve rome, ashkallike dhe egjiptase në informata lidhur me masat parandaluese të COVID-19, shërbimet sociale, si dhe me ruajtjen e pasurisë së tyre. Ky është projekti i parë në kuadër të disa projekteve që do të realizohen në 12 komuna të Kosovës deri në nëntor të vitit 2020. UNHCR, UNMIK dhe palët e tjera ndërkombëtare vazhduan me përkrahjen e komuniteteve rome, ashkallike dhe egjiptase në marrjen e dokumenteve personale dhe në zgjidhjen e çështjeve të statusit civil për t'ua mundësuar qasjen në shërbime publike. Në kuadër të reagimit ndaj COVID-19, UNKT-ja ka rifuqizuar përkrahjen e tij për komunitetet rome, ashkallike dhe egjiptase, posaçërisht në fushën e të ushqyerit dhe të higjienës, shëndetësisë, shkollimit, dokumentacionit civil dhe në atë të përfshirjes sociale, duke vlerësuar vazhdimisht ndikimin e pandemisë në këto komunitete për të siguruar ndihmesë me fokus të veçantë tek gratë dhe fëmijët. Gjatë periudhës në shqyrtim, nuk janë dhënë kontribute në Fondin e mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara për përkrahjen

e komuniteteve rome, ashkalike dhe egjiptase të prekura nga helmimi me plumb në Kosovë, duke e lënë kështu Fondin pa mundësi të mbështetjes së nevojave të tyre urgjente.

## **VII. Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut**

28. Gjatë periudhës raportuese, prokurorët dhe gjykatat e Kosovës kanë ngritur aktakuza dhe kanë shpallur aktgjykime në disa raste të profilit të lartë të krimit të organizuar e korrupsionit. Në prill, 19 individë, duke përfshirë deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe tre ish-ministra, u akuzuan për keqpërdorim të pretenduar të detyrës apo të autoritetit zyrtar lidhur me procesin e privatizimit të Korporatës Energjetike të Kosovës në vitin 2013. Një akuzë po ashtu është ngritur më 23 prill kundër pesë zyrtarëve policorë të Kosovës lidhur me krim të organizuar, keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar dhe për kontrabandë të mallrave. Në maj, Zyra e Prokurorisë Speciale e Kosovës ka ngritur akuzë për krim të organizuar kundër shtatë individëve të akuzuar për transport dhe shitje të paautorizuar të armëve dhe për shitje të paautorizuar të substancave narkotike. Zyra e Prokurorisë Speciale ngriti akuzë edhe ndaj 33 personave për keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar, marrje të rryshfetit, kontrabandë të mallrave dhe për pronësi e posedim të paautorizuar të armëve.

29. Njëkohësisht, organizatat vendore të shoqërisë civile vazhduan të raportojnë përparim të ngadaltë në trajtimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke shprehur shqetësime për dënime shpesh të buta të shqiptuara. Më 23 qershor, Instituti i Kosovës për Drejtësi, botoi një raport ku në bazë të të gjeturave nga monitorimet sistematike të 334 rasteve të korrupsionit dhe të 1180 seancave gjyqësore gjatë vitit 2019 del se shumica e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe të përfshirjes në krim të organizuar janë hedhur poshtë apo janë mbyllur nga Prokuroria. Më 31 gusht, Këshilli Prokurorial i Kosovës gjithashtu botoi një raport, ku vlerësohej puna e sistemit prokurorial në trajtimin e rasteve në gjashtë vitet e fundit. Në raport vërtetohen të gjeturat e Institutit të Kosovës për Drejtësi se shumica e raporteve dhe hetimeve të lidhura me rastet e nivelit të lartë të korrupsionit dhe të krimit të organizuar janë hedhur poshtë apo janë mbyllur.

30. Gjykatat e Kosovës gjithashtu shpallen aktgjykime për disa raste të krimeve të luftës dhe raste të lidhura me to. Në prill, Gjykata Supreme riktheu në gjykim rastin kundër ish-pjesëtarit të njohur të UÇK-së, i cili akuzohej për krime që pretendohet të jenë kryer në Suharekë në qershor të vitit 1999. Gjithashtu në prill, Gjykata themelore në Prishtinë shpalli aktgjykimin ku shpallej fajtor ish-kryetari i komunës së Skenderajt lidhur me ikjen e tij nga paraburgimi që kishte ndodhur dy herë, gjegjësisht në gusht dhe në shtator të vitit 2015, derisa ishte gjykim për krime të luftës kundër popullatës civile. Ai u dënua me gjobë në shumë prej 12.000 euro. Më 22 qershor, Gjykata themelore në Prizren shpalli fajtor ish-pjesëtarin e policisë rezerve të Jugosllavisë për krime të luftës kundër popullatës civile, të kryera në fshatin Krushë e Madhe në mars të vitit 1999, gjegjësisht ai u shpall fajtor për plaçkitje dhe shkatërrim të pronës, si dhe për përdhosje të kufomave të një numri të panjohur të personave të paidentifikuar, me ç'rast u dënua me 22 vjet burg.

31. Në fund të qershorit, Zyra e Prokurorit për Krime të Luftës e Serbisë shpalli ngritjen e aktakuzës kundër një shqiptari të Kosovës, i cili ishte arrestuar dhe dërguar në mbajtje në

janar të vitit 2020 në Beograd lidhur me krimet që pretendohet të jenë kryer në fshatin Rudicë të komunës së Klinës në korrik të vitit 1999. Gjykata e lartë në Beograd më pas ktheu aktakuzën dhe kërkoi nga prokurori kryerjen e hetimeve të mëtejshme.

32. UNMIK-u vazhdoi me mbështetjen e përpjekjeve për zbardhjen e fatit të 1643 personave që ende janë të zhdukur që nga lufta në Kosovë. Më 30 qershor, UNMIK-u ofroi pajisje dhe përkrahje teknike grupit punues të Beogradit dhe Prishtinës për persona të zhdukur lidhur me ngjarjet në Kosovë me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve të grupit për të bashkërenduar, këmbyer dhe përpunuar informatat për personat e zhdukur. Më 30 gusht, në Ditën Ndërkombëtare të Viktimave të Zhdukjeve të Dhunshme, Përfaqësuesi im Special rikonfirmoi përkrahjen e UNMIK-ut për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur në Kosovë. Qasja në këtë informatë është e drejtë themelore dhe element thelbësor i ndërtimit të besimit dhe të pajtimit mes komuniteteve.

33. UNMIK-u vazhdoi që të monitoroj nga afër ndikimet ndryshuese të COVID-19 në të drejtat e njeriut dhe masat për mbajtjen nën kontroll të tij, posaçërisht lidhur me ndikimin joproportional tek komunitetet joshumicë dhe personat në situata të cenueshme, siç janë gratë dhe vajzat, personat e moshuar, personat e privuar nga liria dhe personat në lëvizje. Më 4 prill, duke reaguar ndaj raporteve të medieve për publikimin e informatave personale të individëve në karantinë, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë lëshoi një deklaratë ku kërkohet nga mediet që të respektojnë Kushtetutën dhe ligjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale. Përfaqësuesi im Special ftoi të gjitha institucionet dhe palët me interes që të mbesin syçelë ndaj stigmatizimit dhe diskriminimit të mundshëm lidhur me luftimin e COVID-19 dhe gjithashtu ftoi në një reagim gjithëpërfshirës për t'u siguruar që askush të mos mbetet i lënë anash dhe që të respektohet e drejta e pacientëve në privatësi.

34. Gjatë periudhës në shqyrtim, ekipi përgatitor për themelimin e komisionit të Kosovës për të vërtetën dhe pajtimin vazhdoi me mbajtjen e konsultimeve publike me anëtarët e shoqërisë civile, me intelektualët dhe me komunitetet në mbarë Kosovën ku janë diskutuar modalitetet e punës dhe juridiksioni i një komisioni të tillë. Më 8 qershor, UNMIK-u ishte pjesëmarrës i një takimi virtual, gjatë së cilit ekipi përgatitor u raportoi palëve me interes lidhur me procesin e hartimit të një propozimakti normativ dhe me dispozitat e tij kryesore.

35. Kosova vazhdoi ndjekjen penale të individëve të dyshuar për pjesëmarrje në luftëra të huaja dhe terrorizëm. Në qershor dhe korrik, Departamenti special i Gjykatës themelore të Prishtinës shpalli fajtores shtatë gra që ishin pjesë e grupit të personave të riatdhësuar në Kosovë nga Republika Arabe e Sirisë në prill të vitit 2019 (shih S/2019/461). Gjykata i dënoi secilën me nga dy vite burgim me kusht dhe në këshillim të obligueshëm psikologjik. Po ashtu, Gjykata e Apelit shpalli aktgjykimet në rastet kundër tre meshkujve nga i njëjti grup, duke i rritur dënimet e shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë për dy persona dhe duke e konfirmuar dënimin e shqiptuar për personin e tretë.

36. Në vazhdën e raporteve se masat për mbajtje nën kontroll të COVID-19 kanë rritur rastet e dhunës kundër fëmijëve, Ligji për mbrojtjen e fëmijëve hyri në fuqi më 17 korrik. Në Ligjin e ri parashihet mbrojtja e fëmijëve nga dhuna fizike e psikike, keqtrajtimi, shfrytëzimi, neglizhenca dhe nga format e tjera të dhunës që rrezikojnë jetën, sigurinë, shëndetin,

shkollimin dhe zhvillimin e tyre. Ky Ligj, përmes cilit interesi i fëmijës vihet në rend të parë, është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me parimet e Kushtetutës.

## **VIII. Gratë, paqja dhe siguria**

37. Gjatë periudhës raportuese, komisioni i qeverisë së Kosovës përgjegjës për verifikimin dhe njohjen e statusit të viktimës së dhunës seksuale të lidhur me konfliktin ka pranuar 63 aplikacione, duke e sjellë kështu në 1303 gjithsej numrin e aplikacioneve të pranura që nga themelimi në shkurt të vitit 2018. Deri më sot, 846 aplikues (819 femra dhe 27 meshkuj) kanë fituar statusin e të mbijetuarës/it, ndërsa 262 aplikacione (224 femra dhe 38 meshkuj) janë refuzuar.

38. Fillimi i pandemisë COVID-19 shënoi gjithashtu edhe fillimin e rritjes së rasteve të dhunës në familje dhe të dhunës me baza gjinore. Nga janari deri në qershor të vitit 2020, policia e Kosovës ka raportuar 1012 raste të dhunës në familje, krahasuar me 785 sa ishin gjatë të njëjtës periudhë në vitin 2019, që paraqet rritje për 29 për qind. Gjatë periudhës raportuese, Grupi shumëpalësh për siguri dhe çështje gjinore, i cili udhëhiqet nga Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Gruas (UN- Women) dhe përfshin UNMIK-un si anëtar, është përqendruar në ofrimin e ndihmesës për gratë dhe vajzat në tejkalimin e ndikimit negativ të masave të izolimit, në veçanti nga rreziku i dhunës në familje dhe të asaj në baza gjinore. Në partneritet me UN-Women, UNMIK përkrahu strehimoret për viktimat e dhunës në familje në mbarë Kosovën përmes donacioneve të çarçafëve dhe rrobave, si dhe të pajisjeve për shkollimin nga distanca të fëmijëve që jetojnë në strehimore. Për më tepër, është filluar një fushatë e vetëdijesimit me spote televizive që nxisnin të mbijetuarat/it të raportojnë dhunën në familje, dhe janë shpërndarë materiale informuese e pamore për raportimin e rasteve të dhunës në familje. Gjatë muajve të parë të izolimit nga COVID-19, Misioni i OSBE-së në Kosovë gjithashtu nisi një fushatë kundër dhunës në familje në të gjitha gjuhët zyrtare për të njoftuar qytetarët për shërbimet dhe përkrahjen në dispozicion të viktimave. Fushata është përkrahur nga KFOR-i, i cili emetoj radioporusi në gjuhën shqipe dhe atë serbe.

39. Më 29 qershor, kryetari i komunës së Zubin Potokut dhe kryeshefi ekzekutiv i komunës së Mitrovicës së Veriut inauguruan strehimoren e parë regjionale për të mbijetuarat/it e dhunës në familje dhe të dhunës gjinore në veri të Kosovës. Ndërtimin e strehimores e ka financuar UNMIK-u. Kryetari i komunës së Gjakovës më 2 shkurt ka nënshkruar marrëveshjen me strehimoren lokale të grave për viktimat e dhunës në familje ku parashihet dhënia e kontributit vjetor në shumë prej 4000 euro për një periudhë trevjeçare.

40. Në kuadër të nismave të reagimit ndaj COVID-19, filmi dokumentar i prodhuar nga UNMIK-u “Nuk është pronë e jotja” është emetuar në një kanal lokal televiziv më 2 korrik, dhe është pasuar me diskutim të nivelit të lartë për ndikimin e COVID-19 tek gratë. Ky dokumentar pati më shumë se 171.000 shikime në mediet shoqërore. Po kështu, 54 gra dhe gjashtë meshkuj kanë përmirësuar jetesën e tyre përmes projektit për krijimin e të ardhurave, të financuar nga UNMIK-u, ku është përfshirë edhe prodhimi i rreth 24.000 maskave, të

cilat në muajin korrik u janë shpërndarë popullatës së cënueshme në pesë komuna të Kosovës.

41. Derisa shumica e shkollarëve kanë mundur të përfundojnë vitin shkollor përmes mësimi nga distanca, të realizuar nga Ministria e Arsimit e Kosovës, mungesa e qasjes në pajisjet e teknologjisë informative dhe e lidhjes me internet ka thelluar pabarazitë ekzistuese dhe ka prekur negativisht të drejtat e disave në shkollim. Cënueshmëria e vajzave dhe djemve të komuniteteve rome, ashkalike dhe egjiptase, dukshëm është thelluar nga pandemia COVID-19. Shumica e fëmijëve nga këto komunitete, posaçërisht vajzat dhe gratë e reja, nuk kanë qasje në pajisjet e teknologjisë informative apo në internet. Duke marrë parasysh obligimet e rritura të kujdesit në shtëpi, gratë e reja dhe vajzat janë në rrezik të humbjes së vitit shkollor dhe rrjedhimisht edhe nga braktisja e plotë e shkollës.

## **IX. Ndërtimi i besimit, partneriteti dhe bashkëpunimi**

42. Gjatë periudhës raportuese, projektet e ndërtimit të besimit të Misionit u përshtatën për të mbështetur popullin e Kosovës në luftimin e pandemisë dhe përmbushjen e nevojave emergjente, duke siguruar që ato të kontribuonin në objektivat e tyre të përgjithshëm për ndërtimin e besimit. Platforma e ndërtimit të besimit në Kosovë, e cila u prezantua praktikisht më 17 mars, ofroi informacione mbi shëndetin publik në gjuhët lokale, ndërsa vazhdoi të gjurmojë dhe shkëmbejë informacione mbi përpjekjet e palëve bazë dhe atyre të shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve qendrore dhe lokale të Kosovës, për të çuar përpara rekomandimet e Forumit të Ndërtimit të Besimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, të mbajtur në maj të vitit 2018 në Lubjanë, Slloveni. Në qershor, UNMIK-u, në bashkëpunim me IOM-in, përfundoi fazën e dytë të një iniciative për ndërtimin e besimit që synon promovimin e mësimi të të dy gjuhëve zyrtare, zgjerimin e përmbajtjes së fjalorëve në internet shqip-serbisht dhe serbisht-shqip, mbështetjen e institucioneve të Kosovës në shpërndarjen e informacionit mbi COVID-19 në të dy gjuhët zyrtare, si dhe përgatitjen e materialeve në internet lidhur me COVID-19. Seria e debateve në kuvende komunale për ndërtimin e besimit, e sponsorizuar nga UNMIK-u, gjithashtu u përshtat për të trajtuar çështjet dhe shqetësimet në lidhje me COVID-19 përmes mjeteve virtuale. Debatet, intervistat e ekspertëve mjekësorë dhe artikujt e botuar gjatë periudhës raportuese kishin 1.971,000 shikime të kombinuara nëpër platformat e mediave sociale të Kosovës.

43. Si rezultat i masave të kufizimit të COVID-19 të vendosura në mes të marsit, Misioni modifikoi mbështetjen e tij në qendrën e parë pilot për fëmijët e pastrehë dhe familjet e tyre në Kosovë, për të mundësuar mbajtjen e mësimi virtual dhe ofrimin e mbështetje psikologjike dhe këshillimin. Përveç kësaj, u shpërndanë pako ushqimore dhe higjienike për 25 familje të pastreha, duke përfshirë 52 të rritur dhe 131 fëmijë. Në konsultim me UNKKT-në, këto aktivitete plotësojnë iniciativat e UNICEF-it të përqendruara në qasje të vazhdueshme të shërbimit shëndetësor esencial dhe ushqimit për gratë, për fëmijët dhe për komunitetet në nevojë, dhe arsimimin e vazhdueshëm, mbrojtjen sociale dhe përkrahjen për mbrojtjen e fëmijëve.

44. UNMIK-u vazhdoi të sigurojë mbështetje për integrimin e gjyqësorit dhe administrimin e drejtësisë në përputhje me rekomandimet e Forumit të Ndërtimit të Besimit në Kosovë, me fokus në nevojat që rezultojnë nga pandemia e COVID-19. UNMIK-u, në partneritet me organizatën vendore joqeveritare Qendrën Advokuese për Kulturë Demokratike, vazhdoi të mbështesë Gjykatën themelore të Mitrovicës në përkthimin e dosjeve të lëndëve për të zvogëluar numrin e rasteve të pazgjidhura. UNMIK-u gjithashtu mbështeti integrimin e avokatëve të rinj serbë të Kosovës në sistemin juridik të Kosovës përmes trajnimeve që synonin provimin e avokaturës së Kosovës, si dhe gjyqësorin dhe praktikën ligjore. Me fondet programore të siguruar nga UNMIK-u, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ndihmoi gjykatën themelore të Prishtinës, Ferizajt, Gjilanit dhe Gjykatën Supreme me përkthimin e dosjeve të lëndëve, dhe ofroi një trajnim pesëjavor për 30 interpretë të gjykatave në aftësitë e përkthimit ligjor. Më 25 qershor, kryetari i Gjykatës themelore të Mitrovicës përuroi gjykatoren e re në Gjykatën themelore të Mitrovicës, e cila në tërësi ishte mobiluar dhe pajisur nga UNMIK-u.

45. Qendra e ndihmës juridike e Institutit Ligjor të Kosovës e mbështetur nga UNMIK-u, ofroi ndihmë juridike falas për 611 individë (207 femra dhe 404 meshkuj) për çështje që lidhen me të drejtat pronësore, të drejtat e punës, të drejtat e pensionistëve dhe dhunën në familje. Gjatë muajit maj, si pjesë e një projekti të financuar nga UNMIK-u, organizata joqeveritare vendore Nisma për Drejtësi dhe Barazi, organizoi një seri trajnimesh në internet mbi dhunën në familje, urdhrat për mbrojtje, ndarjen e pasurisë së përbashkët dhe mjetet financiare për policinë dhe personelin e sistemit të drejtësisë. Ajo gjithashtu publikoi një seri artikujsh mbi njohuritë ligjore dhe videomateriale për të drejtat e viktimave dhe këshillimin ligjor për të mbijetuarat/it e dhunës në familje.

46. Më 31 mars, me mbështetjen nga UNMIK-u, Zyra e Kombeve të Bashkuara për drogat dhe krimin dhe Agjencia e Bashkimit Evropian për trajnime mbi zbatimin e ligjit, përfunduan një projekt të përbashkët rajonal në mbështetje të ndërtimit të kapaciteteve për hetimet financiare në Evropën Juglindore që filloi në vitin 2017. Gjatë fazës përfundimtare të projektit, më shumë se 100 përfaqësues nga agjencia për zbatimin e ligjit dhe gjyqësori i Kosovës, të cilët morën pjesë në trajnim, hartuan një kurrikulë për hetimet financiare të përshtatur me kornizën ligjore të Kosovës. Projekti rriti kapacitetet e Kosovës për të trajtuar financimin kundër pastrimit të parave dhe kundër terrorizmit, dhe promovoi bashkëpunim të fuqishëm midis agjencive ligjzbatuese në rajon.

47. UNMIK-u vazhdoi të mbështesë angazhimin e tij me organizatat e shoqërisë civile të përqendruara në të drejtat e njeriut, për të ndihmuar në mbështetjen e dialogut ndërkomunitar dhe inkurajimin e monitorimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut në nivelin bazë, si dhe shqetësimet tjera lidhur me të drejtat e njeriut. UNMIK-u mbështeti disa organizata vendore të shoqërisë civile për të drejtat e njeriut në hartimin e raportit të tyre të parë të përbashkët mbi situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë, i cili u botua më 30 qershor. Raporti, i cili plotëson një boshllëk të pranishëm në monitorimin dhe raportimin e të drejtave të njeriut në Kosovë, u përpilua në fund të një procesi pjesëmarrës që bashkoi përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile me prejardhje të ndryshme etnike, në harmoni me përpjekjet e UNMIK-ut për ndërtimin e besimit. UNMIK-u vazhdoi punën e tij në mbështetje të agjendës për të rinjtë, për paqen dhe për sigurinë, përfshirë reagimin ndaj pandemisë COVID-19. Nga marsi deri në qershor, UNMIK-u organizoi dhjetë diskutime në internet me të rinjtë dhe përfaqësuesit vendorë nga dhjetë komuna të përziera etnike, të cilat rezultuan me disa aktivitete të përbashkëta, përfshirë shpërndarjen e pajisjeve mbrojtëse personale dhe përfshirjen e këshillave të të rinjve në grupet për veprime emergjente në komunën e Vushtrisë, Lipjanit, Rahovecit dhe Istogut. Si vazhdim i takimeve komunale, në korrik dhe gusht, UNMIK-u mbështeti vullnetarët e rinj çiklistë në shpërndarjen e më shumë se 1.300 maskave të ripërdorshme tek mbi 500 familje të rrezikuara, përfshirë komunitetet joshumicë, dhe 2.100 postera me informacion ndërgjegjësimit për COVID-19 në komunën e Lipjanit, Prizrenit, Kaçanikut dhe Fushë Kosovës. Veprime të ngjashme janë planifikuar në komunitatet e tjera të Kosovës. UNMIK-u gjithashtu mbështeti qendrën e inovacionit në Mitrovicë, qendrën e inovacionit në Graçanicë dhe qendrën rinore shumëetnike në Kllokot, duke siguruar printerë kompjuteri 3D dhe fije për të prodhuar maska mbrojtëse të fytyrës. Midis majit dhe qershorit u prodhuan mbi 900 maska mbrojtëse të fytyrës dhe iu dorëzuan stafit mjekësor vendas dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor në vijën e parë. Për më tepër, Qendra Rinore për Diversitet Kulturor dhe Zhvillim të Pakicave e mbështetur nga UNMIK-u në Kllokot, zhvilloi punëtori të përjavshme në internet mbi shëndetin mendor, njohuritë mbi mediet digjitale dhe luftimin e dezinformimit dhe gjuhës së urrejtjes në internet. Këto punëtori përshëndetën fushatën e ndërgjegjësimit në internet nga Grupi për veprim i rinisë së bashkuar të mbështetur nga UNMIK-u, duke kontaktuar me mbi 12.000 të rinj.

48. Më 7 gusht, UNMIK-u prezantoi punën e tij mbi bashkëpunimin rinor ndëretnik në një ngjarje të organizuar nga UNKT dhe Shoqata e Krishterë e të Rinjve (YMCA) në Kosovë, në kuadër të fushatës UN75. Në vazhden e miratimit të rezolutës 2535 (2020) të Këshillit të Sigurimit të 14 korrikut 2020 për rininë, paqen dhe sigurinë, më 27 gusht, UNMIK-u, Misioni verifikues i KB-së në Kolumbi dhe Misioni i ndihmës i KB-së për Irakun, organizoi platformën e parë rinore të përbashkët në internet për të ndarë përvojat dhe idetë e të rinjve kosovarë, irakianë dhe kolumbianë në ndërtimin e paqes dhe luftimin e pandemisë COVID-19. Kjo ngjarje bashkoi ndërtuesit e rinj të paqes nga Kosova, Iraku, Kolumbia, Afganistani dhe Meksika për të diskutuar pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e paqes dhe vendimmarrjes, sfidat në lidhje me angazhimin e grave të reja në iniciativat e ndërtimit të besimit, rëndësinë e punës së të rinjve për pajtimin dhe ndërtimin e kujtesës kolektive, dhe rëndësinë e aktiviteteve kulturore dhe të tjera për të ndihmuar ndalimin e ndarjeve në komunitet. Më 9 shtator, UNMIK-u, së bashku me përfaqësuesit e të rinjve nga Kosova, gjithashtu paraqiti arritjet e tij në ndërtimin e besimit të të rinjve në një takim të formulës Arria mbi zbatimin e agjendës së të rinjve, paqes dhe sigurisë nga operacionet paqësore të KB-së.

49. Gjatë periudhës raportuese, UNMIK-u mbështeti lëshimin e 26 letërreshtimeve të kuqe dhe shtatë kërkesave për ekstradim në Kosovë nga anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL). Ai hapi 608 lëndë për hetim brenda bazës së të dhënave të INTERPOL-it, duke e çuar numrin e përgjithshëm të lëndëve të hapura në lidhje me territorin ose popullin e Kosovës në 560. UNMIK-u gjithashtu përpunoi 4.806 artikuj të korrespondencës zyrtare të INTERPOL-it. Përveç kësaj, në korrik qeveria e Kosovës nënshkroi një dokument "marrëveshje pune" me Agjencinë e Bashkimit Evropian për bashkëpunim në zbatimin e ligjit (EUROPOL) mbi bashkëpunimin në luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe formave të tjera të krimit të rëndë.

## **X. Vrojtimet**

50. Unë shpreh solidaritetin tim të thellë me popullin e Kosovës gjatë kohërave të vështira të shkaktuara nga pandemia globale. Po ashtu, jam i kënaqur që UNMIK-u dhe UNKT-ja janë në gjendje të mbështesin përpjekjet e institucioneve të Kosovës për të parandaluar përhapjen e COVID-19 dhe për të zbutur efektet socio-ekonomike të krizës shëndetësore, veçanërisht në popullatën më të rrezikuar. Unë i mirëpres angazhimet e lidhshme të Kosovës për të luftuar pandeminë dhe për të çuar përpara Dialogun me Beogradin dhe integrimin evropian. Unë gjithashtu i bëj thirrje Qeverisë së re të Kosovës që të vazhdojë forcimin e shtetit të së drejtës, të mbështesë proceset e përgjegjësive për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, të ndërmarrë hapa të vendosur për të luftuar korrupsionin dhe mosndëshkueshmërinë, dhe të zbatojë kornizat e të drejtave të njeriut, duke përfshirë sigurimin e një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut në reagimin ndaj COVID-19 dhe shërimin nga ky virus.



51. Unë jam i shqetësuar nga polarizimi politik që vazhdon në Prishtinë dhe që ka ndikuar në menaxhimin e pandemisë. Së këndejmi, u bëj thirrje të gjitha subjekteve politike në Kosovë të bashkohen rreth prioriteteve të ruajtjes së shëndetit publik dhe mbështetjes së institucioneve publike në sigurimin e një përgjigje koherente dhe efektive, për të frenuar pandeminë dhe sfidat e shëndetit publik dhe ato socio-ekonomike lidhur me të.

52. Rritja e rasteve të raportuara të dhunës në familje që nga fillimi i pandemisë COVID-19 është shqetësuese. Andaj, inkurajoj institucionet e Kosovës të fuqizojnë përpjekjet e tyre për të zbatuar mbrojtje ligjore dhe të tjera dhe për të adresuar pabarazitë e përjetuara nga gratë. Qeveria duhet të vazhdojë përpjekjet për të ndihmuar të mbijetuarat/it e dhunës seksuale lidhur me konfliktin, përfshirë sigurimin e mbështetjes së përgjithshme të përqendruar tek viktimat.

53. Gjithashtu, mirëpres që UNMIK-u dhe partnerët e tij përshtatën me shpejtësi aktivitetet e tyre programore për ndërtimin e besimit për të mbështetur menaxhimin e pandemisë dhe për të përmbushur nevojat emergjente të Kosovës. Përdorimi kreativ i mjeteve strategjike të komunikimit, të tilla si Platforma shumëgjuhëshe e ndërtimit të besimit në Kosovë dhe debatet nëpër komuna, kontribuan në sigurimin e shpërndarjes së informacioneve të rëndësishme mbi shëndetin publik në komunitetet anembanë Kosovës. UNMIK-u dhe Ekipi i KB-së për Kosovë do të vazhdojnë t'i përshtatin operacionet e tyre në ambientin e ndryshuar dhe t'i japin përparësi mbështetjes për Kosovën, veçanërisht për më të rrezikuar.

54. Unë e mirëpres rifillimin, pas pezullimit të zgjatur, të Dialogut të përkrahur nga BE-ja midis Beogradit dhe Prishtinës. Angazhimi i ripërtërirë drejt normalizimit të marrëdhënieve është i qartë dhe shpresoj të mbetet i tillë derisa të gjendet një zgjidhje gjithëpërfshirëse. Jam i inkurajuar nga pjesëmarrja konstruktive e të dy palëve në fazën fillestare të negociatave të mbështetura nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian, Lajçak, dhe angazhimi i vazhdueshëm personal i Përfaqësuesit të Lartë të BE-së, Borrell. Palët duhet të bazohen në përparimin e arritur deri më tani në diskutimet, duke përfshirë rezultatin e marrëveshjeve të nënshkruara nga palët me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara në lidhje me "normalizimin ekonomik". Shpresoj që diskutimet e vazhdueshme do të ndihmojnë në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, dhe të arrihet progres në kthimin e personave të zhvendosur e në bashkëpunimin ekonomik, si dhe në zbatimin e marrëveshjeve të tjera të pazbatuara.

55. I bëj thirrje lidhshpimit në Beograd dhe në Prishtinë të demonstrojnë fleksibilitet dhe kreativitet për të kapërcyer dallimet. Nga liderët politikë kërkoj të sigurojnë një qasje gjithëpërfshirëse përmes pjesëmarrjes më të madhe të akterëve kryesorë, veçanërisht të grave dhe të rinjve, në proceset e konsultimit dhe vendimmarrjes, dhe përfshirjen e perspektivave gjinore dhe të të rinjve në zbatimin e marrëveshjeve që ndikojnë në jetën e popullatës

56. Jam i shqetësuar për tensionet e rishfaqura për ndërtimet në Zonën e posaçme të mbrojtur përreth manastirit të Deçanit, lokacionin i trashëgimisë botërore të UNESCO-s. Ndërsa punimet janë pezulluar, një angazhim i qartë nga autoritetet e Kosovës për të respektuar legjislacionin, përfshirë vendimin e Gjykatës Kushtetuese që mbështet të drejtat pronësore të Kishës Ortodokse Serbe, do të jetë i rëndësishëm për ruajtjen e besimit ndërkombëtar.

57. Dëshiroj të përsëris zotimin e Kombeve të Bashkuara për të mbështetur komunitetin ashkali, egjiptas dhe rom të prekur nga helmimi me plumb në Kosovë. Për fat të keq, nuk ka pasur kontribute të mëtjshme në Fondin e Mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara, i krijuar për të mbështetur projekte që synojnë të mirën e këtyre komuniteteve. Andaj, përsëris thirrjen time për kontribute vullnetare nga shtetet anëtare dhe akterë e organizata të tjera, për të mundësuar një përgjigje efektive plotësimin e nevojave të komuniteteve të rrezikuara.

58. Gjatë periudhës raportuese, Zyra e Prokurorit të Specializuar bëri përparim në vazhdimin e hetimeve të saj. Ju bëj thirrje të gjitha palëve përkatëse, institucioneve të Kosovës dhe **palëve** ndërkombëtare që të ofrojnë mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre të plotë për këto përpjekje, të cilat janë thelbësore për të ardhmen paqësore të Kosovës.

59. Falënderoj Përfaqësuesin tim Special, Zahir Tanin, për udhëheqjen e tij gjatë kësaj periudhe të vështirë dhe gjithë stafin e Misionit për përkrahjen e tyre të përkushtuar ndaj Kosovës, përfshirë edhe tejkalimin e sfidave të pandemisë. Gjithashtu, dua të ritheksoj mirënjohjen time për Koordinatorin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, si dhe agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara për bashkëpunimin e tyre të vlefshëm me UNMIK-un dhe partnerët e kahmotshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, përfshirë KFOR-in, Bashkimin Evropian dhe OSBE-në.

## Shtojca I.

### **Raporti i Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm mbi aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë nga 16 mars deri më 15 shtator 2020.**

#### **1. Përmbledhje**

Pandemia COVID-19 la në hije periudhën e raportimit. Përkundër situatës së jashtëzakonshme, Misioni vazhdoi të përmbushë mandatin e tij, megjithëse me një prani të reduktuar fizike.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe Përfaqësuesi i Lartë, Josep Borrell, përmes një shkëmbimi të letrave, u pajtuan për një zgjatje teknike njëvjeçare të mandatit të Misionit 2018-2020 për shkak të pandemisë. Ndërkohë Misioni rifilloi të gjitha detyrat e tij të mandatuara.

Pas vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për të hequr kufizimet e tij të lidhura me pandeminë dhe për të lejuar rifillimin e seancave gjyqësore, Misioni rifilloi aktivitetet e tij të monitorimit të lëndëve. Këto kufizime lejuan që të mbaheshin vetëm disa seanca dëgjimore urgjente. Njësia e EULEX-it për Monitorimin e Lëndëve (NJML) rishikoi gjykimet që po mbahen e që ndoshta duhet të fillojnë përsëri sepse asnjë seancë nuk u zhvillua për tre muaj rresht.

NjML gjithashtu mori pjesë në disa grupe pune për rishikimin funksional të sektorit të sundimit të ligjit të udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë, një proces që synon reformat në sistemin e drejtësisë (përfshirë vetingun) si dhe në një grup pune për finalizimin e Kodit të ndryshuar të Procedurës Penale.

Për më tepër, Misioni kontribuoi në hartimin e Ligjit të ri të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK), duke marrë pjesë në nivelin e ekspertëve në grupet punuese përkatëse.

Në mbështetje të Dialogut të përkrahur nga BE-ja midis Beogradit dhe Prishtinës, Misioni vazhdoi të lehtësojë zbatimin e Protokollit Teknik të MNK (IBM) dhe marrëveshjeve të Dialogut në lidhje me lirinë e lëvizjes dhe gjyqësorin. Në këtë drejtim, EULEX-i mori pjesë në grupin punues që harton Strategjinë e re Kombëtare të MNK (IBM).

Fati i personave të zhdukur vazhdoi të tërheqë vëmendjen gjatë periudhës raportuese, dhe roli pozitiv i EULEX-it në identifikimin e mbetjeve të personave të zhdukur u theksua në një numër raportesh të mediave vendase dhe ndërkombëtare.

Në maj, EULEX-i filloi fushatën mediatike "Flisni me kohë" duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së provave biologjike në rastet e dhunës seksuale. Kjo është pjesë e një fushate të ndërgjegjësimit që po vazhdon, të cilën Misioni dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) e filluan vitin e kaluar.

EULEX-i vazhdoi të mbështesë Policinë e Kosovës në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në nivele të ndryshme. Gjithashtu, Misioni ruajti kapacitetet e tij të ndërhyrjes së shpejtë si përgjegjësi i dytë i sigurisë, dhe vazhdoi mbështetjen e tij për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Përmes IML, Misioni mbështeti homologët e tij vendorë në gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur.

## **2. Aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX Kosova)**

### **2.1. Monitorimi**

Pas vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) për heqjen e kufizimeve të tij në lidhje me pandeminë dhe për të lejuar rifillimin e seancave gjyqësore, Misioni rifilloi aktivitetet e tij për monitorimin e lëndëve. Njësia për Monitorimin e Lëndëve e EULEX-it (NjML) mori pjesë në seancat gjyqësore të të gjitha lëndëve që po i monitoron si të rëndësishme, ndërsa vazhdonte të ndiqte dhe analizonte zhvillimet procedurale të lëndëve ekzistuese dhe të sapo monitoruara. KGjK-ja ka ndaluar publikun edhe mediat të marrin pjesë në seancat gjyqësore, por ka lejuar në mënyrë të veçantë EULEX-in të monitorojë të gjitha seancat në përputhje me mandatin fuqiplotë të monitorimit të këtij Misionit.

Si pasojë e masave të vendosura COVID-19, gjatë gjithë periudhës raportuese u mbajtën vetëm disa seanca dëgjimore urgjente. Misioni rishikoi gjykimet që po mbaheshin, të cilat mund të duhet të fillojnë përsëri sepse seancat nuk u zhvilluan për tre muaj rresht. Kjo masë përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe ka prekur një numër të konsiderueshëm të gjykimeve, përfshirë rastet e profilit të lartë. Deri më tani, palët janë pajtuar në shumicën e lëndëve të monitoruara nga EULEX-i, që dëshmitë e mëparshme t'i konsiderojnë si të lexuara, duke shmangur kështu riadministrimin e provave në dhjetë lëndë. Derisa marrëveshje të tilla mundësojnë vazhdimin e gjykimit, ato megjithatë mund të rrezikojnë të kundërshtohen ligjërisht pasi KPP-ja kërkon qartë që në raste të tilla të gjitha provat duhet të shqyrtohen përsëri. EULEX-i rekomandoi marrjen e mendimit juridik mbi këtë çështje nga Gjykata Supreme. Nga 40 lëndë të monitoruara nga Misioni, deri më tani në dhjetë lëndë dëshmitë janë konsideruar si të lexuara, ndërsa për të tjerat mbetet të shihet nëse kjo do të ndodhë në mënyrë që të shmangët riadministrimi i provave, gjë që do të vononte më tej drejtësinë. Po ashtu, në një rast gjyqtari caktoi seancën vetëm brenda afatit dhe në një rast tjetër avokatët mbrojtës kundërshtuan që të shqyrtonin të gjitha dëshmitë e lexuara. Misioni do të monitorojë nga afër rezultatit e të gjitha këtyre lëndëve, prej të cilave 21 konsiderohen raste të profilit të lartë. Në dhjetë lëndë seancat dëgjimore u shtyn pasi gjykatat nuk mund të garantonin respektimin e masave të ndërlidhura me pandeminë në sallat e gjykatave.

Misioni gjithashtu shqyrtoi lëndët të cilat ka të ngjarë të arrijnë periudhën e parashkrimit si rezultat i seancave që ishin ndaluar. Ndërkohë, Misioni bashkëpunoi ngushtë me Zyrën e BE-së / PSBE-së për të kërkuar nga KGJK-ja të veprojë në rastet që do të duhej të fillonin përsëri.

Misioni vazhdimisht shprehu shqetësim për shkallën e lartë të lëndëve që dërgohen për rigjykim nga Gjykata e Apelit, një praktikë e cila duhet të mbështetet vetëm në rrethana të kufizuara dhe të bazuara.

Pas rekomandimit të Misionit, KGJK-ja emëroi dy gjyqtarë serbë të Kosovës në Divizionin e Gjykatës së Apelit në Mitrovicë. Me këtë emërim, që ka hyrë në fuqi më 1 korrik, Divizioni tani ka katër gjyqtarë serbë dhe tre shqiptarë, siç përshkruhet në Marrëveshjen për Drejtësi e nënshkruar midis palëve brenda kornizës së Dialogut të përkrahur nga BE-ja.

Monitoruesit e drejtësisë të EULEX-it morën pjesë në konferencën në internet të organizuar nga OJQ Aktiv me bazë në Mitrovicë, mbi projektpropozimin për ndryshime në Ligjin për përdorimin e gjuhëve, duke ofruar komente dhe këshilla.

Misioni mori pjesë në disa grupe punuese që merren me reformat e sundimit të ligjit. Një ekspert i Misionit mori pjesë në takimin hyrës në internet të nëngrupit punues të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit (RFSSL) për gjyqësorin, i kryesuar nga Ministria e Drejtësisë (MD). Grupi do të përqendrohet në përmirësimin e përgjegjësisë, profesionalizmit, kompetencës dhe integritetit në sistemin gjyqësor dhe prokurorial (përfshirë vetingun), si pjesë e një procesi gjithëpërfshirës që çon në finalizimin e një strategjie të përgjithshme për sektorin e sundimit të ligjit. EULEX-i gjithashtu mori pjesë në nëngrupin punues RFSSL mbi drejtësinë penale, e cila përqendrohet në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë. Për më tepër, një ekspert i EULEX-it mori pjesë në takimin në internet të nëngrupit punues RFSSL mbi antikorrupsionin, duke u përqendruar në masat strategjike për reformimin e kornizës institucionale antikorrupsion dhe rritjen e sinergjive të prokurorisë policore, të tilla si krijimi i byrosë kombëtare për luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë dhe gjykatave kundër korrupsionit.

Përveç kësaj, Ministria e Drejtësisë e ftoi EULEX-in të marrë pjesë në dy grupe punuese shtesë. Një grup punues synon të trajtojë llogaridhënien, ndërsa qëllimi i grupit tjetër punues është të finalizojë Kodin e ndryshuar të Procedurës Penale. Propozimi i ministrit të ri të drejtësisë mbi procesin e vetingut bëri që disa ekspertë nga shoqëria civile të jepnin dorëheqje nga grupi punues, që u krijua nga qeveria e mëparshme. Qeveria e re pezulloi gjithashtu vendimet e mëparshme që synonin ndalimin e nepotizmit ose parregullsitë në emërimin e diplomatëve në institucionet e huaja.

EULEX-i ka vazhduar avokimin për nevojën e legjislacionit përkatës ose të një rregulloreje, e cila lejon gjykatat të mbajnë seanca gjyqësore në internet për të parandaluar kalimin e afateve ligjore. Sipas praktikave më të mira të BE-së, autoritetet gjyqësore në shumë shtete anëtare të BE-së, kanë miratuar ose ndryshuar ligje që lejojnë seancat të zhvillohen në mënyrë virtuale.

Në shkurt të vitit 2020, të gjitha gjykatat themelore në Kosovë filluan të përdorin një sistem automatik të caktimit të lëndëve. Megjithatë, kryetarët e gjykatave themelore caktuan manualisht lëndët që po ashtu u ishin caktuar automatikisht gjyqtarëve nga sistemi. Ekspertët e EULEX-it morën pjesë në diskutime për të adresuar këtë çështje, dhe së bashku me disa palë të tjera, përfshirë Zyrën e BE-së, nuk pajtoheshin me këtë praktikë të propozuar të caktimit manual të lëndëve, pasi që ofron hapësirë për ndërhyrje në ndarjen e rasteve.

Instituti i Drejtësisë së Kosovës (IDK) nxori një raport të titulluar "Drejtësia në sytë e qytetarëve". Raporti është rezultati i fazës së parë të projektit të financuar nga EULEX-i "Ndërtimi i besimit në sistemin gjyqësor dhe përmirësimi i realizimit të të drejtave të njeriut përmes monitorimit laik të gjykimeve". Projekti u implementua nga IDK nga tetori 2019 deri në mars të vitit 2020. Tetëmbëdhjetë monitorues joekspertë (laikë), të zgjedhur nga një gamë e larmishme e moshave, gjinive, etnive dhe rajoneve, monitoruan 360 seanca gjyqësore penale në tërë Kosovën. Ata vlerësuan seancat dëgjimore penale mbi të drejtat e njeriut dhe çështjet e drejtësisë procedurale, duke përfshirë barazinë para ligjit, transparencën dhe paanësinë e gjykatave dhe të drejtat e gjykimit të drejtë. IDK analizoi reagimet nga monitoruesit laikë dhe hartoi raportin e vlerësimit.

Ekspertët e EULEX-it morën pjesë në mënyrë aktive në një videokonferencë televizive me Komisionin e Venecias, ku morën pjesë gjithashtu PSBE si dhe Ambasada e Britanisë dhe ajo e ShBA-së. Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës më pas dha një mendim mbi disa dispozita të caktuara të Draft Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht për gjykimin në mungesë dhe pezullimin e zyrtarëve nga detyra, i cili pasqyron komentet dhe propozimet e sugjeruara ndër të tjera nga EULEX-i.

Përmes monitorimit të rregullt, Misioni arriti në përfundimin se të gjitha institucionet korrektuese të Kosovës po aplikojnë masa adekuate mbrojtëse anti-COVID-19 si për personelin, ashtu edhe për të burgosurit.

EULEX-i i dhuroi pajisje të IT-së Shërbimit Korrektues të Kosovës për të lejuar të burgosurit të komunikojnë me anëtarët e familjes dhe për të lehtësuar kontaktet midis stafit.

Misioni mori pjesë në një grup punues që punonte në përgatitjen e Ligjit të ri të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK). Po ashtu, Misioni paraqiti disa rekomandime mbi draftin e rishikuar, përfshirë edhe nevojën për të rritur transparencën në punën e ShKK-së.

Misioni vazhdoi të monitorojë situatën në vendkalimet e përbashkëta midis Serbisë dhe Kosovës pas heqjes së tarifave për importet nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, dhe përgatiti një pasqyrë analitike të importeve të mallrave, transportit të mallrave komerciale dhe shoferëve që dalin nga Kosova për në Serbi.

Gjithashtu, Misioni ndihmoi me kërkesat për informacion midis Doganave të Kosovës dhe Serbisë në përputhje me mekanizmin e Protokollit Teknik të MNK (IBM) për shkëmbimin e informacionit, i cili është pjesë e marrëveshjeve të arritura brenda Dialogut të përkrahur nga BE-ja. Misioni do të vazhdojë monitorimin dhe ndihmën për të siguruar që mekanizmi i shkëmbimit të informacionit të kthehet në rrugën e duhur.

Misioni mori pjesë në grupin punues për hartimin e Strategjisë së re Kombëtare të MNK (IBM), ku vazhdimisht kishte avokuar që strategjia të ishte një dokument i pavarur me një buxhet të vetëm të dedikuar, të cilin qeveria më në fund e pranoi.

Ekspertët e EULEX morën pjesë në grupin punues për prezantimin e masave dhe procedurave që përfshijnë Informacionin e Avancuar të Pasagjerëve (IAP) dhe Regjistrat e Emrave të Pasagjerëve (REP) në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Udhëzimi administrativ përfundimtar tani është aprovuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ky është një zhvillim i rëndësishëm që Kosovës i mundëson të jetë në përputhje me udhëzimet e BE-së për të luftuar imigracionin e parregullt dhe për të përmirësuar kontrollin e kufirit.

Misioni vazhdoi takimet e rregullta ballë për ballë ose telefonatat me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe me Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC). Njësia e Misionit për mbështetjen e Dialogut (IBM, Liria e Lëvizjes dhe Marrëveshja e Drejtësisë) mori pjesë në një seminar dyditor të kryesuar nga Përfaqësuesi Special i BE-së për Dialogun dhe çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor, Miroslav Lajçak. Kjo njësi mbajti konferenca të shkurtra për secilën nga marrëveshjet përkatëse të Dialogut të përkrahur nga BE-ja, duke u përqendruar në arritjet sa i përket zbatimit dhe në sfidat e ardhshme.

Misioni vazhdoi të mbështesë Gjykatën themelore të Mitrovicës dhe divizionin e Gjykatës së apelit në Mitrovicë në zbatimin e Marrëveshjes së Drejtësisë të mbështetur nga BE-ja.

## **2.2. Operacionet**

Më 27 korrik, Kosova dhe EUROPOL-i nënshkruan një marrëveshje pune që rrit bashkëpunimin midis agjencive për zbatimin e ligjit të Kosovës dhe organizatës ndërkombëtare të policisë me seli në Hagë. Ndërkohë, EULEX-i ka vazhduar të ndihmojë shkëmbimin e saktë dhe në kohë të informacioneve ndërmjet EUROPOL-it dhe Policisë së Kosovës, mbi hetimet e krimeve të rënda përmes zyrës ndërlidhëse suedeze të Europolit.

Njësia policore e formuar nga EULEX-i si përgjegjësi i dytë i sigurisë në Kosovë, shërbeu si mbështetje për drejtoritë rajonale të Policisë në Mitrovicën e Jugut dhe Mitrovicën e Veriut gjatë protestave të mbajtura nga Vetëvendosje. Misioni gjithashtu ndihmoi operacionet e OSBE-së gjatë mbledhjes së votave në Kosovë për zgjedhjet serbe të mbajtura më 21 qershor, përmes pranisë së një oficeri ndërlidhës të EULEX-it në qendrën e operacioneve të OSBE-së. Kjo ishte gjithashtu një mundësi e shkëlqyeshme për të rishikuar dhe provuar procedurat dhe aktivitetet e përbashkëta me Policinë e Kosovës (PK) dhe KFOR-in.

Misioni mbështeti Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML) në Kosovë në zhvarrosjen e mbetjeve trupore nga varret në komunën e Pejës dhe Mitrovicës, në të cilat u gjetën mbetje të plota të viktimave të lidhura me konfliktin.

Projekti "Ruajtja e provave mbi dhunën seksuale", në veçanti fushata "Flisni me kohë" u mbështet nga EULEX-i dhe u implementua nga IML në bashkëpunim me Policinë e Kosovës (PK). Rreth 800 studentë morën pjesë në leksionet e mbajtura nga një ekip i përbërë nga dy ekspertë vendorë nga IML dhe një anëtar i PK-së.

## **Shtojca II.**

### **Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar**

Më 12 mars të vitit 2020, Qeveria e Holandës deklaroi zbatimin e masës kombëtare për të rritur sigurinë publike si reagim ndaj pandemisë COVID-19. Brenda natës, Dhomat e Specializuara (DHS) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) aktivizuan një plan të vazhdimësisë së punës duke zhvendosur shumicën e stafit të punojnë në distancë. Marrëveshjet e punës në distancë mbeten në fuqi që atëherë, me vetëm një ekip shumë të kufizuar që punon në objekt.

Pavarësisht nga vendosja e masave të posaçme për shkak të pandemisë, puna e DHS dhe ZPS ka vazhduar pandërprerë, madje e intensifikuar.



Objekti i paraburgimit në DHS është plotësisht funksional. Më 16 mars, ai u plotësua me staf dhe i gjithë trajnimi i nevojshëm i stafit dhe përgatitjet teknike përfunduan deri më 1 prill.

Më 17 mars u mbyll thirrja për propozimin e gjyqtarëve për t'u caktuar në listën gjyqtarëve ndërkombëtarë. Paneli i pavarur i përzgjedhjes që u emërua ka përfunduar procesin e përzgjedhjes dhe e ka dorëzuar raportin e tij tek autoriteti emërtues.

Më 23 prill, Prokurori i Specializuar njoftoi Kryetarin e DhS për qëllimin e tij për të filluar procedurat pranë DhS. Në përputhje me Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Kryetari caktoi një gjyqtar të procedurës paraprake për të shqyrtuar aktakuzën e ngritur nga Prokurori i Specializuar. Gjyqtari i procedurës paraprake ka deri në gjashtë muaj kohë për të vendosur nëse do të konfirmojë apo jo aktakuzën.

Më 29 dhe 30 prill, gjykatësit e DhS zhvilluan seancën e tyre plenare vjetor përmes videokonferencës. Gjatë kësaj seance plenare, gjykatësit zgjedhën një nënkryetar të ri dhe miratuan 30 amendamente në rregulloren e punës dhe të provave të DhS (rregullat).

Më 26 maj, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese nxorri vendimin e saj, duke konstatuar se të gjitha 30 amendamentet e Rregullores së miratuar janë në përputhje me kapitullin II të Kushtetutës. Kështu, ndryshimet e Rregullores së miratuar hynë në fuqi.

Aktivitetet e komunikimit të DhS kanë vazhduar dhe shumë shpejt u zhvendosën në internet për shkak të pandemisë. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur nëntë ngjarje në terren. Gjashtë nga këto ngjarje ishin me studentë në Kosovë dhe tre me gazetarë shqipfolës dhe serbishtfolës. DhS gjithashtu janë angazhuar me rrjetin e tyre të informacionit të gjykatës, dhe më 26 mars drejtuan një takim virtual për të marrë reagime mbi videoklipet e përgatitura rishtas dhe aktivitetet e planifikuara në terren për muajt e ardhshëm. Po ashtu, në mars ofiqari i DhS nënshkroi një marrëveshje granti me qeverinë zvicerane në lidhje me aktivitetet e komunikimit në terren të DhS për vitet 2020 dhe 2021. Programi i vizitorëve të DhS gjithashtu u zhvendos në internet dhe vazhdon të mirëpresë grupe për të mësuar rreth DhS dhe ZPS.

Numri i pyetjeve mediatike të pranuar nga DhS është rritur me regjistrimet nga Prokurori i Specializuar në shkurt dhe prill, si dhe me pyetjet në lidhje me ndikimin që mund të ketë pandemia në punën e DhS dhe ZPS. Gjatë periudhës raportuese, është rritur raportimi i saktë nga ana e mediave. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në mënyrë që të sigurojmë viktimat, dëshmitarët dhe të tjerët e prekur që puna të vazhdojë pa ndërprerje.

DhS dhe ZPS kaluan nga periudha e tretë buxhetore në të katërtën, kur buxheti për periudhën 15 qershor 2020 deri më 14 qershor 2021 mori miratimin përfundimtar nga Këshilli Evropian, më 11 qershor 2020.

Më 24 qershor, u botua një listë e përditësuar e avokatëve mbrojtës të specializuar të cilët janë të kualifikuar të punojnë në DhS. Lista aktuale përmban 179 mbrojtës, prej të cilëve 89 janë të kualifikuar për të përfaqësuar viktimat. Procesi i aplikimit mbetet i hapur.

Kryetari, Ofiqari dhe Prokurori i Specializuar vazhduan angazhimin e tyre me shtetin nikoqir Holandën, me shtetet anëtare të BE-së, shtetet kontribuese dhe të tjerët. Më 9 korrik, drejtuesit organizuan një konferencë në internet për ambasadorët e shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuese në Hagë. Njëzet e shtatë shtete morën pjesë në këtë konferencë, gjatë së cilës ata u përditësuan nga drejtuesit mbi zhvillimet më të fundit dhe pjesëmarrësit parashtuan pyetje.

Në fillim të shtatorit u miratuan rregulloret për ndihmë juridike nga ofiqari i DhS, pas konsultimeve me Kryetarin e DhS, dhe ato u publikuan në internet. Rregulloret ilustronë praktikën më të mirë në standardet e ndihmës juridike, duke garantuar pajtueshmërinë me parimet e gjykimit të drejtë të parashikuar në Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, duke siguruar menaxhim të duhur financiar të burimeve të skemës së ndihmës juridike. Rregulloret përcaktojnë procesin për të dyshuarit ose të akuzuarit pranë DhS për të marrë ndihmë juridike, plotësisht ose pjesërisht, nëse ata kanë demonstruar se nuk kanë mundësi të paguajnë për mbrojtjen e tyre ose nuk marrin ndihmë juridike përmes mënyrave të tjera.

Pavarësisht nga pandemia e koronavirusit, ZPS vazhdoi të zbatojë mandatin e saj. Më 24 qershor, ZPS lëshoi një deklaratë duke njoftuar se në prill kishte ngritur një padi në DhS prej dhjetë pikash për t'u shqyrtuar nga Gjykata, duke akuzuar Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe të tjerët për një sërë krimesh kundër njerëzimit dhe krime të luftës, përfshirë vrasje, zhdukje me forcë të personave, përndjekje dhe tortura. Prokurori i Specializuar e konsideroi të nevojshme lëshimin e këtij njoftimi publik për akuzat për shkak të përpjekjeve të përsëritura nga z. Thaçi dhe z. Veseli për të penguar dhe diskredituar punën e DhS. Në periudhën raportuese, ZPS ka vazhduar intervistimin e të dyshuarve, të viktimave dhe dëshmitarëve, si dhe ka vazhduar me mbledhjen dhe shqyrtimin e provave të tjera. Për të përmbushur mandatin e saj, ajo vazhdon të kërkojë angazhimin dhe mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare, të organizatave ndërkombëtare dhe të shteteve veç e veç.

### Shtojca III

#### **Përbërja dhe fuqia e komponentës policore e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (deri më 15 shtator 2020)**

Shteti	Gra	Burra	Numri
Gjermania		1	1
Hungaria		1	1
Federata Ruse	1	1	2
Turqia		1	1
Ukraina		1	1
<b>Gjithsej</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>6</b>

#### **Përbërja dhe fuqia e komponentës ndërlidhëse ushtarake e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (deri më 15 shtator 2020)**

Shteti	Gra	Burra	Numri
Republika Çeke		2	2
Polonia		1	1
Republika e Moldavisë		1	1
Rumania		1	1
Turqia		1	1
Ukraina	1	1	2
<b>Gjithsej</b>	<b>1</b>	<b>7</b>	<b>8</b>

# UNMIK

SEPTEMBER 2020

UNITED NATIONS  
Geospatial



21°E



The boundaries and names shown and the designations used on this map do not imply official endorsement or acceptance by the United Nations.

Map No. 4133 Rev. 84  
Sep 2020

21°E